

VII PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

NOCIONET KRYESORE:

Shefi i shtetit; mandati; imuniteti; inkopatibiliteti; përgjegjësia; vetoja.

PYETJE :

- 1. Sa zgjat mandati i Presidentit të RM-së ?**
- 2. Cilat kushte duhet t'i plotësojë një person që të mund të zgjidhet president i Republikës ?**
- 3. Me çka është inkopatibil funksioni i presidentit të RM-së ?**
- 4. Kush vendos për heqjen e imunitetit të presidentit të RM-së ?**
- 5. Kush e zëvendëson presidentin e RM-së në rast të vdekjes, dorëheqjes, ose pengese të vazhdueshme në kryerjen e funksionit ?**
- 6. Cilat janë autorizimet e presidentit në lidhje me udhëheqjen e politikës së jashtme.**
- 7. Cilat janë autorizimet e presidentit në fushën e mbrojtjes së vendit ?**
- 8. Kush janë bartësit e funksioneve publike që i propozon presidenti i Republikës ?**
- 9. Çfarë përmban e drejta e vetos së presidentit të RM-së ?**
- 10. Kush mund të propozojë kandidat për president të RM-së ?**
- 11. Sqaroje procedurën për zgjedhjen e presidentit !**
- 12. Sa shumicë votash duhet të përvetësojë kandidati për president që të zgjidhet në raundin e parë ?**
- 13. Sa shumicë votash duhet të përvetësojë kandidati për president që të zgjidhet në raundin e dytë ?**
- 14. Para kujt jepë betimin solmn presidenti i Republikës para se ta marrë detyrën ?**
- 15. Për çfarë përgjigjet presidenti i Republikës ?**
- 16. Kush ngre procedur për përgjegjësinë e presidentit të Republikës ?**
- 17. Kush vendos për përgjegjësinë e presidentit të Republikës ?**

1. Pozita e presidentit të Republikës së Maqedonisë

Institucioni president i Republikës është element i rëndësishëm i sistemit kushtetues dhe politik dhe dallimet në raport me funksionet, vendin dhe rolin e shefit të shtetit janë bazë ose të paktën një ndër elementet e rëndësishme për kualifikimin e sistemit politik.

Shefi i shtetit është organ i cili historikisht, para formimit të parlamentit, i ka ushtruar të gjitha funksionet e shtetit. Duke pasur parasysh dallimet e funksioneve shtetërore dhe organeve të tjera shtetërore, shefi i shtetit ngel bartësi i pushtetit ekzekutiv. Në përfundimet teorike për shefin e shtetit shpeshherë nisët nga fakti që ai përfaqëson shtetin dhe sovranitetin shtetëror brenda dhe jashtë vendit dhe se ai është bartës i disa prerogativave të pushtetit ekzekutiv. Shefi i shtetit zakonisht është udhëheqës nominal ose lider ceremonial – ai që e simbolizon kombin.

Kushtetuta e RM-së e definojnë presidentin e RM-së si organ i cili *përfaqëson Republikën dhe si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura të Maqedonisë.*

Pozita e shefit të shtetit varet nga shumë faktorë.

Dallimi i parë që mund të bëhet ndërmjet asaj që quhet shefi i shtetit në vende të ndryshme del nga ajo se a është shteti i rregulluar si *monarki ose republikë*. Dallimi kryesor ndërmjet shefit të shtetit në monarki dhe republikë është mënyra me të cilën ato vinë në pushtet. Në monarkit shefi i shtetit – monarku vjen në pushtet në rrugë trashëguese: ndërsa në republika shefi i shtetit i -quajtur president (në qoftë se është organ individual) vinë në pushtet nëpërmjet zgjedhjeve. Monarku sundon “ sipas mëshirës së Zotit ” ose drejtëpërdrejt – mbi bazë të kushtetutës, pa pasur mundësi qytetarët të vendosin për ardhjen e tij në pushtet, ndërsa në republika qytetarët drejtëpërdrejt ose tërthorazi marrin pjesë në përcaktimin e personave që do të kryejnë funksionin e shefit të shtetit. Dallimi akoma më i rëndësishëm qëndron në faktin që monarku është politikisht dhe penalisht i papërgjegjshëm, ndërsa shefi i shtetit në republika gjithëkund mban përgjegjësi penale, kurse në disa vende edhe përgjegjësi politike, përkatësisht përgjegjësia penale dhe materiale presidentit është rregull, ndërsa përgjegjësia e tij politike – përjashtim. Duke marr parasysh faktin që pushteti gjendet atje ku është përgjegjësia, pushteti në monarkitë e sotme parlamentare ka kaluar nga sunduesi i papërgjegjshëm në duart e ministrave me përgjegjësi, përkatësisht përgjegjësia politike dhe pushteti politik janë në duart e qeverisë, përderisa shefi i shtetit është shef formal i pushtetit ekzekutiv.

Pozita e presidentit të republikës varet nga sistemi i organizimit të pushtetit. Në sistemin presidencial presidenti ka autorizime të forta. Në republikën parlamentare presidenti nuk ka më shumë pushtet se monarku parlamentar dhe pushteti i tij faktik është zvogëluar shumë dhe atë në dobi të kryeministrit, ndërsa në sistemet e përziera roli i tij është forcuar. Në sistemin parlamentar (sisteme të bashkuara të pushtetit) shefi i shtetit varet nga kuvendi dhe atij i përgjigjet.

Do të thotë, pozita dhe roli politik i shefit të shtetit janë të ndryshme në vende të ndryshme dhe varen nga rregullimi shtetëror dhe tipi i organizimit të pushtetit, por domethënia e këtij institucioni varet edhe nga shumë faktorë të tjerë siç janë: *mënyra e të ardhurit në pushtet*, përgjegjësia, gjerësia e autorizimeve dhe kështu me radhë.

Shefi i shtetit, të cilin e zgjedh drejtëpërdrejt populli, ka pozitë më të fortë shumë më të pavarur nga presidenti të cilin e zgjedh parlamenti. Presidenti zgjidhet drejtëpërdrejt në sistemet politike kushtetuese të cilat i quajmë sisteme presidenciale dhe të përziera – gjysmëpresidenciale. SHBA-të në njëfarë mënyre, shikuar formalisht, duken si përjashtim nga kjo, për arsye se presidentin e zgjedhin elektorët si trup i veçantë, por ato në mënyrë adekuate e përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve, përkatësisht kanë të njëjtin efekt sikur të ishin në pyetje zgjedhjet e drejtëpërdrejta. Roli i përforcuar i presidentit të shtetit, në shtetet ku ai zgjidhet drejtëpërdrejt, del nga fakti që ai ka të njëjtin legjitimitet sikurse edhe parlamenti.

Nga mënyra e zgjedhjes së shefit të shtetit del edhe mundësia e shkarkimit të tij nga funksioni, përkatësisht *përgjegjësia* e tij. Në vendet ku presidenti zgjidhet drejtëpërdrejt nga populli, ai nuk përgjigjet para ndonjë organi tjetër që ka të njëjtin legjitimitet demokratik – parlamenti. Por, kjo nuk do të thotë që presidenti nuk është i përgjegjshëm fare, ai i nënshtrohet përgjegjësisë penale. Në sistemet parlamentare, presidenti i republikës nuk ka përgjegjësi politike, për shkak se përgjegjësin politike për veprimtarinë e ekzekutivit, në përgjithësi, e bartë qeveria, e cila formalisht e merr përgjegjësinë e akteve të presidentit në bazë të kundërfirmosjes. Në sistemet e bashkimit të pushtetit ku trupi legjislativ ka rol primar, shefi i shtetit është politikisht përgjegjës para parlamentit.

Pozita e shefit të shtetit në disa raste varet edhe nga kohëzgjatja e *mandatit* të tij dhe nga (pa) mundësia për *rizgjedhje*. Në praktikë mandati i kryetari të shtetit është i kufizuar në katër, pesë, gjashtë ose shtatë vjetë. Mandati me kohëzgjatje të caktuar dhe me kohëzgjatje të konsiderueshme është i domosdoshëm që presidenti të jetë i përgatitur dhe i vendosur për të luajtur mirë rolin e tij, ndërsa shoqëria të ketë mundësi të provojë se në ç'drejtim po shkojnë planet e tij, të krijojë mendim për vlerat e tij. Mundësia për rizgjedhje është e domosdoshme që t'i mundësojë popullit, në qoftë se e miraton sjelljen e presidentit, edhe më tutje ta mbajë në pozitë, duke vazhduar në këtë mënyrë t'i shfrytëzojë aftësit dhe të arriturat e tij dhe duke i siguruar pushtetit përparësinë e vazhdimësisë në kuadër të një sistemi të kuptueshëm të administrimit.

Problemi i rizgjedhjes mund të shqyrtohet nga dy qasje të ndryshme:

- në qoftë se ekziston mundësia për rizgjedhje, atëherë në funksionin e presidentit të republikës jepet mundësia e karizmatizmit, që i jep presidentit të republikës, si bartës i pushtetit ekzekutiv, mundësi për shtrirjen dhe ndërhyrjen në “ pushtetin tjetër ”, që mund të ndikojë dukshëm në pozitën dhe veprimtarinë e pushtetit

legjislativ. Për këtë arsye është e nevojshme të ketë kufizime në numrin e rizgjedhjes dhe mandat më të shkurtër;

- në qoftë se ndryshimet në krye të shtetit janë më të shpeshta, mund të ndikojnë në mënyrë destabilizuese.

Mandati i presidentit të RM-së zgjat 5 vjet, me mundësi rizgjedhjeje vetëm një herë. Do të thotë për president të Republikës një person mund të zgjidhet më së shumti dy herë. Personi që kandidohet për president të RM-së duhet t,i plotësojë kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i RM-së;
- në ditën e zgjedhjeve të ketë mbushur më së paku 40 vjet;
- deri në ditën e zgjedhjeve të ketë qenë banor i RM-së më së paku 10 vjet në 15 vitet e fundit. Në këtë periudhë llogaritet edhe koha e qëndrimit në republikat e tjera të RSFJ-së (neni 80 dhe neni 132).

Detyra e presidentit të Republikës, sipas Kushtetutës së RM-së, është e papajtueshme me kryerjen e ndonjë *funksioni tjetër publik, profesioni ose funksioni në parti politike*. Dispozita për inkompatibilitet të funksionit të presidentit është e njëjtë me dispozitën për inkompatibilitet të funksionit të kryetarit të Kuvendit. Këtë e potencojmë për arsye se në publik shpesh herë inkompatibiliteti i funksionit të kryetarit të shtetit gabimisht ndërlihet me papajtueshmërinë e këtij funksioni me anëtarësimin në parti politike, e jo me kryerjen e ndonjë funksioni në parti politike.

Presidenti i RM-së gëzon *imunitet*. Për heqjen e imunitetit të presidentit të Republikës vendos Gjykata Kushtetuese e RM-së me dy të tretat e shumicës së votova nga gjithë numri i gjyqëtarëve.

Në rastë vdekjeje, dorëheqie, pamundësie të përhershme për ushtrimin e funksionit ose ndërprerja e mandatit sipas forcës së Kushtetutës, deri në zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës, funksionin e Presidentit të Republikës e ushtron kryetari i Kuvendit. Kushtet për ndërprerjen e funksionit të Presidentit të Republikës e vërteton Gjykata Kushtetuese e RM-së. Në rast pamundësie për ushtrimin e funksionit, Presidentin e Republikës e zëvendëson kryetari i Kuvendit. Kur kryetari i Kuvendit ushtron funksionin e presidentit të Republikës, ai merr pjesë në veprimtarinë e Kuvendit pa të drejtën e vendosjes.

2. Kompetencat e Presidentit të Republikës së Maqedonisë

Kompetencat që bien në sferën e kryetarit të shtetit mund t'i ndajmë në dy grupe.

1. Ajo që është e përbashkët për funksionin e kryetarit të shtetit në të gjitha vendet është autorizimi i tij për *ta përfaqësuar shtetin brenda dhe në marrdhëniet ndërkombëtare*. Në këtë cilësi kryetari i shtetit ka autorizime të rëndësishme në udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit:

- emëron dhe liron përfaqësues diplomatik të RM-së në shtetet e tjera;
- pranon letra kredenciale dhe revokuese nga përfaqësues të huaj diplomatikë;
- lidh marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë;
- mund të propozojë hyrjen në federatë ose bashkësi ose tërheqjen nga federata ose bashkësi me shtete të tjera.

2. Në fushën e *mbrojtjes*, kryetari i shtetit:

- është komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura;
- mund të propozojë shpalljen e gjendjes së luftës ose gjendjen e jashtëzakonshme;
- në qoftë se Kuvendi nuk mund të mblidhet, mund të marrë vendim për shpalljen e luftës, përkatësisht gjendjen e jashtëzakonshme dhe ia drejton Kuvendit për vërtetim, sapo të ketë mundësi të mblidhet.

3. Një pjesë e kompetencave të kryetarit të shtetit janë të lidhura me *propozimin dhe zgjedhjen e organeve të tjera*:

- cakton mandatarin për formimin e Qeverisë;
- propozon dy gjyqëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan;
- emëron tre anëtarë të Këshillit të sigurimit të RM-së;
- emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve publike dhe shtetërore të vërtetuara me Kushtetë dhe ligj.

4. Kryetari i shtetit ushtron edhe *kompetenca të tjera*, siç janë:

- jep dekorata dhe mirënjohje në pajtim me ligjin;
- ushtron të drejtën e faljes në pajtim me ligjin. Për dallim nga amnistia, e cila ka të bëjë me një rreth të pacaktuar personash, falja gjithmonë ka të bëjë me persona të caktuar me emër e mbiemër, përkatësisht jepet, për emra që më parë të njohur, persona konkretë në baza individuale. Shikuar në esencë, falja nuk dallohet nga amnistia;
- ushtron edhe funksione të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

5. Kryetari i shtetit ka ndikim edhe në *veprimtarinë normative* të Kuvendit, përmes të drejtës së vetos.

a) *Autorizimi i Presidentit të RM-së për ta njoftuar Kuvendin e RM-së për çështje në kompetencë të tij dhe autorizimi i Kuvendit të RM-së të kërkojë mendim nga Presidenti i RM-së.* Njëra nga mjetet me të cilat Presidenti i Republikës “ ndërhy ” në veprimtarinë e Kuvendit është e drejta e tij për ta njoftuar Kuvendin për çështjet në kompetencën e tij. Presidenti mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë më së paku njëherë në vit. Komenti më restriktivë i dispozitës së nenit 85 paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së, sipas të cilës Presidenti i RM-së e njofton Kuvendin për çështje në kompetencë të tij, do të ishte se me këtë dispozitë Presidenti i Republikës detyrohet ta njoftojë Kuvendin. Por më afër së vërtetës është komentimi i kësaj dispozite si dispozitë e cila i jep të drejtë

Presidentit që nëpërmjet fjalimit të tij drejtuar Kuvendit të ushtrojë ndikim mbi deputetët, mbi Qeverinë dhe mbi publikun, përkatësisht t'i japë sugjestionë Kuvendit, madje edhe propozime konkrete, për rregullimin ligjor të çështjeve dhe marrëdhënieve të caktuara, si dhe në pikëpamje të vetë politikës së Kuvendit.

Por, neni 85 paragrafi 2 i jep të drejtë edhe Kuvendit që ai të mund të kërkojë nga Presidenti i Republikës mendim për çështje në kompetencë të tij. Do të thotë, kjo e drejtë ka pikëpamje të kundërta nga ajo e mëparshmja.

b) *E drejta e vetos suspendive*. E drejta e vetme e Presidentit në procesin e ligjvënies është mundësia e vënies së vetos suspendive mbi ligjin e votuar në Kuvend, përkatësisht të vendosë që mos ta firmosë dekretin për shpalljen e ligjit.

Si është rregulluar e drejta e vetos në Kushtetutën e RM-së? Presidenti i Republikës mund të refuzojë që ta firmosë dekretin për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi. Në rast të tillë, Kuvendi e rishqyrton ligjin dhe, në qoftë se e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Presidenti i Republikës është i detyruar ta firmosë dekretin. Duke pasur parasysh që vetoja e Presidentit mund të hidhet poshtë edhe nga një shumicë më e vogël nga ajo që nga një numër i konsiderueshëm vendesh kërkohet (2/3), roli real i tij konsiston vetëm në kërkesën që deputetët edhe njëherë ta rishqyrtojnë dhe me shumicë absolute ta vërtetojnë vendimin e tyre. Por, Presidenti i RM-së nuk mund të vër veto për ligjet, që sipas Kushtetutës, miratohen me shumicë votash prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në praktikën e deritanishme, Presidenti i RM-së rrallë

herë e ka shfrytëzuar këtë të drejtë. Mangësitë e dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me veton praktikisht u treguan që me veton e parë kushtetuese të Presidentit të vënë mbi ligjin për lidhjen, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Ligji u miratua nga Kuvendi dhe pastaj ngeli në qetësi që zgjati disa muaj. Për disa muaj, Presidenti nuk u deklarua: as që e firmosi dekretin për shpalljen e ligjit, as që vuri veton, duke e kthyer ligjin në Kuvend për rishqyrtim.

Kushtetuta e SHBA-së për raste të tilla ka zgjidhje: në qoftë se Presidenti nuk e firmos, e as e kthen për shqyrtim të sërishëm propozimin e ligjit në Kongres, propozimligji merr forcën ligjore me kalimin e dhjetë ditëve (duke mos llogaritur të dielat), në qoftë se Kongresi nuk shpërndahet në këtë periudhë.

Rasti me Ligjin për lidhjen, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare solli arsyetimin se, të kundërtën e praktikës kushtetuese amerikane, heshtja e Presidentit të RM-së nuk do të thotë pranim i ligjit dhe, ç'është akoma më e tmerrshme, kjo heshtje nuk është e kufizuar në kohë, për arsye se neni 75 i Kushtetutës së RM-së, që ka të bëjë me veton e Presidentit, nuk parasheh afat në të cilin Presidenti është i detyruar ta firmosë ose ta kthiejë ligjin për rishqyrtim në Kuvend. Në këtë mënyrë nëpërmjet ndikimit të Presidentit dhe Kuvendit, si dhe komentimi i kësaj dispozite kushtetuese nga ana e juristëve dhe shkencëtarëve nga publiku, si më dominues iu mvesh arsyetimi se papërsosshmëria kushtetuese lë hapësirë për tejzgjatjen e procedurës për rregullimin ligjor të disa çështjeve të caktuara, për shkak se është lëshuar stimulimi i afatit të vetos presidenciale. Nga ana tjetër, ekziston një pikpamje

tjetër e ndryshme e cila nis nga komentimi krahasues, sistematik i vendimeve kushtetuese të përfshira në nenin 75 dhe nëpërmjet lidhshmërisë së tyre me zgjidhjet e përmbajtura në nenet e tjera të Kushtetutës dhe, sipas së cilave, me gjithatë “ kushtetutbërësi ”, duke dashur ose jo, ka parashikuar afat në të cilin mund të vihet veto mbi një ligj të caktuar.

Fakt është se: Kushtetuta e RM-së është e papërsosur, shpeshherë konfuze, në shumë dipozita jo i plotë. Një numër i madh i dispozitave janë të rregulluara atje ku nuk e kanë vendin, por megjithatë ekzistojnë.

I tillë është vendimi i përfshir në nenin 52 paragrafi 1 dhe 2 që thotë: “ Ligjet dhe vendimet e tjera shpallen para se të hyjnë në fuqi. Ligjet dhe vendimet e tjera shpallen në “ Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë ”, më së voni shtatë ditë nga dita e miratimit të tyre ”. Kjo dispozitë është vendosur në dispozitat që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore. Nuk ka dyshim se kjo dispozitë, bashkë me vijimin e saj, që ka të bëjë me publikimin e ligjeve, afati para hyrjes në fuqi është lënë për arsye të njohjes së publikut me përmbajtjen e ligjeve dhe me ndalimin e veprimit retroaktiv të ligjit, është në funksion të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, por kjo mund të thuhet pothuajse për të gjitha dispozitat kushtetuese. Në fakt, edhe qëllimi i kushtetutës është dhe duhet të jetë të drejtat dhe liritë e njeriut. Pozicionimi i gabuar i kësaj dispozite sjell deri te palidhshmëria e saj me dispozitat e tjera të cilat kanë të bëjnë me procedurën e sjelljes dhe shpalljes së ligjeve.

Cila është lidhja ndërmjet kësaj dispozite dhe vetos së Presidentit? A mundet që afati i dhënë në nenin 52 të llogaritet si afat në të cilin Presidenti i Republikës së Maqedonisë mund të vë veton?

Të rikujtojmë: ligjet i sjell Kuvendi. Ligji i miratuar patjetër duhet të shpallet në Gazetën Zyrtare të RM-së më së voni shtatë ditë nga dita e miratimit. Për t’u publikuar, ligji patjetër të shpallet me dekret të firmosur nga Presidenti i Republikës dhe nga kryetari i Kuvendit. Do të thotë ky afat prej shtatë ditësh duhet të merret si afat në të cilin Presidenti duhet ta firmosë dekretin, ose të vë veto mbi ligjin.

Nga ana tjetër, nga shkakut që Kushtetuta e RM-së nuk lë hapësirë për komentim si ç’është pranuar në SHBA, se heshtja e Presidentit llogaritet si pranim i tekstit që i është afruar për nënshkrim, heshtja e Presidentit të RM-së duhet të llogaritet si veto e vënë.

Kjo mund të ilustruhet me një shembull të thjeshtë. Një grup i caktuar njerëzish është i interesuar për sjelljen e një ligji të caktuar. Ato e ndjekin debatin e hapur në Kuvendin e RM-së, e shikojnë aktin e miratimit të ligjit nëpërmjet votimit të tij me shumicën e duhur nga deputetët. Ato e dinë se për të marrë forcë ligjore një ligj duhet të shpallet në “ Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë ”. Dhe presin ta shohin ligjin e shpallur, duke e ditur që ligji, në pajtim me nenin 52 të Kushtetutës, patjetër duhet të shpallet në afat prej shtatë ditëve. Kalon dita e shtatë ndërsa ligji akoma nuk është shpallur. Shkakut kryesor për mosshpalljen e tij mund të jetë vetëm mosfirmosja e

dekretit për shpalljen e ligjit nga Presidenti i Republikës. Për deri sa dekreti nuk është nënshkruar, do të thotë që Presidenti ka vënë veto.

Në këtë mënyrë, sipas pikëpamjes së dytë të kësaj çështjeje, sipas leximit integral të Kushtetutës mund të arrihet te afati prej shtatë ditëve nga dita e miratimit të ligjit si afat në të cilin presidenti duhet të deklarohet për të ardhmen e ligjit për aq sa ajo varet prej tij.

Është mirë që Presidenti t'i arsyetojë shkaqet e refuzimit të një ligji të caktuar, por kjo nuk është e detyrueshme. Presidenti thjeshtë mund të refuzojë ta firmosë dekretin. Përderisa ai përcaktohet për vendimin e dytë, vetoja fiton efektin e vetë pozitiv. Me fjalë të tjera, me përdorimin e vetos, Presidenti jo vetëm që “ pengon ” një projekt ligjor, përkatësisht nuk shpreh vetëm atë që nuk dëshiron, por duke arsyetuar veton, ai tregon edhe drejtimin në të cilin dëshiron të behen ndryshimet në fushën përkatëse legjislativ.

Presidenti i Republikës së Maqedonisë nuk e ka të drejtën e vetos selektive (*item veto*), përkatësisht veton mbi një pjesë të propozim ligjit. Mospranimi i *item veto* është e arsyetueshme, për arsye se nëpërmjet saj trupi legjislativ do të vihej në një pozitë të pakuptimtë.

Në të drejtën kushtetuese të krahasuar vetoja paraqet mjetin më të rëndësishëm të ndikimit të Presidentit mbi fushën legjislativ. Ajo është shprehja e forcës së Presidentit. Kjo siç thotë Vudro Villson, është “ prerogativi më i madh ” i Presidentit, por në përdorimin e saj Presidenti nuk procedon si pushtet ekzekutiv, por si degë e tretë e organit legjislativ.

Për të fituar kuptimin e vërtetë në Republikën e Maqedonisë, ky instrument duhet përforcuar përmes mundësisë që vetoja të hidhet poshtë vetëm me dy të tretat e shumicës në Kuvend.

3. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë

Presidenti i RM-së zgjidhet në zgjedhjet e përgjithshme të drejtëpërdrejta, me votim të fshehtë, për një afat prej 5 vitesh.

Zgjedhjet për President të Republikës i cakton kryetari i Kuvendit të RM-së. Sipas ligjit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë¹, nga dita e caktimit të zgjedhjes deri në ditën e zgjedhjes nuk mund të kalojnë më shumë se 90 ditë, e as më pak se 70 ditë. Akti i caktimit të zgjedhjes për President të Republikës, në të cilin përcaktohet dita kur fillojnë të ecin afatet për kryerjen e aktivitetit zgjedhor shpallet në “ Gazetën Zyrtare ”.

Zgjedhja për President të Republikës kryhet në 60 ditët e fundit nga mandati i Presidentit të mëparshëm.

¹ “ Gazeta zyrtare e RM-së nr. 20/94 dhe 48/99.

Në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të Presidentit të Republikës, pa marrë parasysh arsyet, zgjedhja e Presidentit të ri kryhet në afat prej 40 ditëve nga dita e ndërprerjes së mandatit.

Kandidat për President të Republikës mund të propozojnë më së paku 10.000 zgjedhës ose më së paku 30 deputetë. I njëjti zgjedhës, përkatësisht i njëjti deputet mund të propozojë vetëm një kandidat për President të Republikës.

Nënshkrimet e zgjedhësve mblidhen në një formular që e bën Komisioni shtetëror i zgjedhjeve në të cilin futet emri dhe mbiemri, adresa dhe numri amë i kandidatit të propozuar dhe i çdo zgjedhësi të nënshkruar. Kjo dispozitë e Ligjit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë² kërkon deklarinimin e hapur të zgjedhësit për kandidaturën e cilit person e jep nënshkrimin. Zgjedhësit nënshkruajnë para organit kompetent për mbajtjen e evidencës për të drejtën elektorale. Mbledhja e nënshkrimeve fillon ditën e pesmbëdhjetë nga dita e caktimit të zgjedhjeve dhe zgjat pesëmbëdhjetë ditë. Në bazë të nënshkrimeve të mbledhura të zgjedhësve, formohen listat e kandidatëve që i firmos përfaqësuesi i autoizuar i dorësuesit të listave, i formularit të shpërndar nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve. Përfaqësuesi i autorizuar është nënshkruesi i parë që propozon, ndërsa zëvendësi i tij është nënshkruesi i dytë.

Listat e kandidatëve për President të Republikës, bashkarisht me deklaratat me shkrim të kandidatëve të propozuar për pranimin e kandidaturës, propozuesit e autorizuar i dorëzojnë te Komisioni shtetëror i zgjedhjeve më së voni 38 ditë para ditës së caktuar për zgjedhje. Kandidati mund të tërhiqet nga kandidatura më së voni 30 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Për President të Republikës është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave nga i gjithë numri i zgjedhësve. Në qoftë se në raundin e parë asnjëri kandidat nuk ka fituar shumicën e duhur të votave, në raundin e dytë votohet për dy kandidat të cilët në raundin e parë kanë fituar më shumë vota.

Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet në afat prej 14 ditëve nga dita e përfundimit të raundit të dytë të votimit. Për President është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave nga zgjedhësit që kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve. Në qoftë se në raundin e dytë të votimit asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e duhur të votave, përsëritet e gjithë procedura e zgjedhjes ?.

Nëse për President të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në raundin e dytë të votimit nuk ka fituar shumicën e duhur të votave, përsëritet e gjithë procedura e zgjedhjes.?

Para marrjes së detyrës, më së voni në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare, por jo më parë se dita e ndërprerjes së mandatit të Presidentit të mëparshëm, Presidenti i Republikës jep deklaratën solemne para Kuvendit me të cilën merr përsipër respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve.

² “Gazeta zyrtare e RM-së “ nr. 20/94.

4. Përgjegjësia e Presidentit të Republikës së Maqedonisë

Presidenti i Republikës përgjigjet për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjeve në ushtrimin e kompetencave dhe të drejtave të tij.

Procedurën për vërtetimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës e ngre Kuvendi me shumicë votash prej dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e Presidentit vendos Gjykata Kushtetuese me shumicë votash prej dy të tretave nga i gjithë numri i gjyqtarëve.

Nëse Gjykata Kushtetuese vërteton përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, funksioni i Presidentit përfundon sipas forcës së Kushtetutës.